

ENTI RREGULATOR I SEKTORIT TE ENERGJISE ELEKTRIKE

METODOLOGJIA E LLOGARITJES SE TARIFAVE TE OPERATORIT TE SISTEMIT TE SHPERNDARJES SE ENERGJISE ELEKTRIKE

PJESA I

Kjo metodologji presupozon qe Operatori i Sistemit te Shperndarjes (OSSH) dhe Furnizuesi Publik me Pakice (FPP) do te jene brenda te njejtes kompani

Autoriteti

Metodologjia e llogaritjes se tarifave te shperndarjes se energjise elektrike eshte hartuar ne perputhje me Ligjin Nr 9072., date 22.05.2003 “Per Sektorin e Energjise Elektrike”, i ndryshuar.

Qellimi

Qellimi i kesaj metodologjie eshte percaktimi i tarifave te perdonimit te rrjetit te shperndarjes bazuar ne parime te qarta te tarifimit dhe detajimi i te dhenave te nevojshme per percaktimin e tarifave te drejta dhe transparente.

Objektivi

Objektivi i kesaj metodologjie eshte hartimi inje metodologje per llogaritjen tarifave per akses ne shperndarje dhe tarifave te perdonimit te rrjetit te shperndarjes per perdonuesit e sistemit shqiptar te shperndarjes, ne perputhje me Traktatin per Komunitetin e Energjise se Europees Juglindore (ECSEE), si dhe te krijoje mundesite qe klientet jo-tarifore dhe centralet prodhuese tregtare te energjise elektrike te marrin pjese ne tregun rajonal.

1. Termat e perdonur ne metodologji

Termat standarte te perdonur ne te gjitha metodologjite e tarifave percaktohen ne Ligjin Per Sektorin e Energjise Elektrike, Rregullat e Tregut, Kodin e Matjes, Kodin e Transmetimit dhe aktet e tjera nenligjore te miratuara nga ERE.

Termat e perdonura ne kete metodologji kane kuptimin si me poshte:

- 1.1 **Faktori i rregullimit/korigjimit vjetor (A)** – një perqindje e barabarte me faktorin e inflacionit minus faktorin e permiresimit te eficences te aplikuar mbi cmimin tavan te vtit tarifor te meparshem.
- 1.2 **Tarifa baze e shperndarjes – vlerat** e tarifave te sherbimit te shperndarjes te percaktuara sipas kostove ne vitin baze.
- 1.3 **Viti baze** – viti i pare i periudhes se rregullimit
- 1.4 **Klientet tarifore** – Kliente te Furnizuesit Publik me Pakice.
- 1.5 **Viti i Testimit**- një periudhe 12-mujore para periudhes se rregullimit qe perdoret si baze per percaktimin e kerkeses per te ardhura ne vitin baze per OSSH.
- 1.6 **Faktori i permiresimit te eficences (faktori X)** – reduktimi vjetor ne perqindje i kostos se sherbimit te shperndarjes qe rezulton nga permiresimi i eficenses operative dhe permiresimet ne teknologji.
- 1.7 **Rregullimi “Cap”** – perdorimi i periudhave te rregullimit ne te cilat te ardhurat apo cmimi maksimal i te licensuarit rregullohen gjate ketyre periudhave te rregullimit.
- 1.8 **Baza e Rregulluar e Aseteve (RAB)** – vlera e aseteve fikse sic percaktohet ne Nenin 6.1 te kesaj metodologje.
- 1.9 **Periudha Rregulatorre** – një periudhe disavjecare ne te cilen çmimet apo kerkesa per te ardhura lejohen te ndryshojne me norma/nivele te caktuara..

2. Rregulla te pergjithshme dhe parimet baze

- 2.1 Mosperputhja me secilen pjese te kesaj Rregulloreje mund te coje ne refuzim nga ana e ERE-s te aplikimit per tarife te kompanise se shperndarjes.
- 2.2 Kjo metodologji eshte hartuar ne perputhje me Ligjin Per Sektorin e Energjise Elektrike, si dhe aktet e tjera ligjore qe jane ne fuqi ne Republiken e Shqiperise dhe aktet e tjera nenligjore te aprovuara nga ERE.
- 2.3 ERE i percakton tarifat per Operatorin e Sistemit te Shperndarjes duke u bazuar ne parimet si me poshte:
 - Nuk duhet te kete ndersubvencionim midis grupeve te konsumatoreve
 - Tarifat per operatorin e sistemit te shperndarjes duhet te reflektojne koston aktuale te sherbimit per cdo grup konsumatoresh sipas niveleve te tensionit;
 - Tarifat duhet te jepin sinjale e duhura per perdorimin me eficence te rrjetit te shperndarjes;
 - Shpenzimet e perfshira ne tarifa duhet te jene transparente per te gjithe palet e interesuara;

- Tarifat duhet t'i lejojne Operatorit te Sistemit te Shperndarjes mundesine e arsyeshme per te realizuar normen e lejuar te fitimit mbi bazen e aseteve te rregulluara, te miratuar nga ERE.
 - Ne tarifat e sherbimit te operatorit sistemit te shperndarjes do te pranohen vetem sherbimet dhe asetet e siguruara ne menyre te kujdeshme ; dhe,
 - Cmimet per sherbimet e shperndarjes duhet te mbeten relativisht te qendrueshme gjate kohes.
- 2.4 Te ardhurat qe lidhen me perdorimin e sistemit te shperndarjes duhet te mblidhen nga klientet tarifore dhe jo tarifore te FPP-se ne menyre transparente dhe jo-diskriminuse. Grupet e krahasueshme te klienteve tarifore dhe jo –tarifore, si dhe centrallet prodhuese te lidhura ne sistemin e shperndarjes, duhet te paguajne te njejtën tarife per perdorimin e rrjetit te shperndarjes, ne menyre direkte ose indirekte.
- 2.5 Klienteve tarifore do t'u shperndahen kostot e humbjeve te energjise ne varesi te nivelit te tensionit ku ata furnizohen. Energjia elektrike e perdorur nga klientet qe nuk maten tek pika e tyre tregetare e levritimit te sherbimit do te rregullohet ne menyre qe te mbulohen humbjet e energjise nga pika tregetare e levritimit tek pika e matjes.
- 2.6 Kosto e blerjes se energjise se nevojshme per mbulimin e humbjeve ne rrjetin e shperndarjes (sipas objektivit te percaktuar nga ERE sipas kesaj metodologje) perfshihet ne tarifen e sherbimit te shperndarjes se energjise elektrike sipas nivelit te tensionit.

3. Periudhat rregullatore, Viti i Testimit dhe Viti Baze

- 3.1 ERE do te percaktoje periudhat e pershtatshme te rregullimit per operatorin e sistemit te shperndarjes duke perdorur metoden e rregullimit “**price cap**” (**çmimi tavan**).
- 3.2 ERE do te miratoje formatet e tabelave per aplikimet per tarifa. Operatori i sistemit te shperndarjes do te perdore formatet e tabelave te miratuara nga ERE kur preqatit aplikimin per cmim per nje periudhe rregullimi. Formatit i tabelave mund te modifikohet per sa kohe qe informacioni eshte organizuar ne menyre te ngjashme dhe detajimi i i informacionit nuk eshte me i vogel se ai i tabelave standarte te miratuara. Tabelat do te tregojne rezultatet e vitit te testimit, rregullimet e bera per vitin e testimit dhe per vitin baze, duke perfshire, por jo vetem, shpenzimet e kompanise, shpenzimet kapitale dhe bazen e aseteve te rregulluara per sherbimin e rregulluar.
- 3.3 Periudhat e rregullimit per sherbimin e rrjetit te shperndarjes do te jene te njejtë me ato te sherbimit te rrjetit te transmetimit.
- 3.4 Tarifa e shperndarjes do te mbuloje koston e pronesise, ndertimit, operimit dhe mirembajtjes se linjave, kabllove, nenstacioneve te transformimit, transformatoreve, ndertesave dhe pajisjeve te komunikimit qe lidhen me to (dhe cdo pajisje/mjet tjeter qe lidhet me sigurimin e sherbimit te dhenies se aksesit ne rrjetin e e shperndarjes).

- 3.5 Rregullimi “Price cap” aplikohet per tarifen mesatare te shperndarjes. ERE miraton ndryshimin mesatar te cmimit per secilen periudhe rregullatore
- 3.6 Metoda “RPI-X” perdoret per t’i dhene operatorit te sistemit te shperndarjes nje nxite per te permiresuar eficensen e operacioneve te tij gjate periudhes rregullatore.
- 3.7 Financimi nepermjet borxheve afat-gjata duhet te perdoret per te financuar shpenzimet per riparim dhe rinosim te kapitaleve ekzistuese dhe kapitaleve te reja, por nuk duhet perdonur per te mbuluar kostot operative.
- 3.8 Operatori i sistemit te shperndarjes do te raportoje ne menyre te qarte dhe te sakte kostot e cdo sherbimi te rregulluar, duke perfshire vetem asetet dhe veprimtarite qe lidhen me sherbimet e rregulluara. Metoda e shperndarjes se kostos duhet te jete e plete dhe e kuptueshme; kjo metode do te miratohet nga ERE.
- 3.9 Kostot e perfshira ne tarifat e operatorit te sistemit te shperndarjes do t’i korrespondojne kostove qe do te ishin realizuar nga nje operator i sistemit te shperndarjes i miremenaxhuar qe ben investime te kujdeshme, minimizon humbjet ne rrjet dhe shmang shpenzimet e panevojshme. Gjate percaktimit te tarifave te DSO per vitin baze, ERE ka te dreje te hetoje nivelet e kostove te raportuara nga operator i sistemit te shperndarjes, dhe t’i krahasoje kostot e saj per njesi me operatore te tjere te sistemit te shperndarjes ne rajon duke marre ne konsiderate ndryshimet e karakteristikave te ketyre operatoreve te sistemit te shperndarjes.
- 3.10 Ne perqatitjen e nje aplikimi per tarifa kompania e shperndarjes do te mundohet te paraqese te gjitha kostot me nje saktesi deri ne 100,000 Leke. Rregulatori nuk do te hetoje per shumat me pak se 100,000 Leke pervec kur ka nje mosmarreveshje lidhur me kompensimin ose pagesen e personave te vecante fizike.

4. Bilancet e energjise elektrike dhe te fuqise

- 4.1 Bilanci i energjise elektrike te sistemit te shperndarjes per vitin baze do te preqatitet duke perllogaritur sasine totale te energjise ne GWh te marre nga operatori i sistemit te shperndarjes gjate vitit baze. Ky total eshte i barabarte me energjine e marre nga sistemi i transmetimit plus energjine e marre nga burimet prodhuese te lidhura me sistemin e shperndarjes. Energjia totale e marre duhet te ndahet ne :
- energji e levruar klienteve tarifore te FPP
 - energji e levruar klienteve jo-tarifore
 - humbjet teknike te energjise ne sistemin e shperndarjes
 - humbjet jo-teknike te energjise ne sistemin e shperndarjes
- 4.2 Bilanci i fluksit te pikut koincidues te ngarkeses se sistemit te shperndarjes do preqatitet duke perllogaritur fuqine totale ne MW te marre nga sistemi i shperndarjes ne oren e pikut. Ky total eshte i barabarte me fuqine e marre nga sistemi i transmetimit plus fuqine e marre nga centralat gjeneruese te lidhur me sistemin e shperndarjes. Fuqia totale e marre duhet te ndahet ne:

- a) fuqia e levruar klienteve tarifore te FPP
 - b) fuqia e levruar klienteve jo-tarifore
 - c) humbjet teknike te fuqise ne sistemin e shperndarjes
 - d) humbjet jo-teknike te fuqise ne sistemin e shperndarjes.
- 4.3 Kompania e shperndarjes do te llogarise shumen totale te te gjithe ngarkesave jo-koincidues sipas niveleve te tensionit per te gjithe klientet me kapacitet te lidhur me te madh se 50 kVA.
- 4.4 Bilancet e energjise dhe te fuqise per sistemin e kombinuar te transmetimit dhe te shperndarjes nuk jane nje zevendesues i pranueshem i bilanceve per sistemin e shperndarjes.
- 4.5 Per secilin nga dhjete vitet e fundit, humbjet e energjise ne sistemin e shperndarjes duhet te tregohen si nje perqindje e energjise se marre nga sistemi i shperndarjes.

5. Kërkesa per te ardhura per Vitin Baze

- 5.1 Shpenzimet e vitit te testimit per percaktimin e kostos baze financiare do te bazohet ne informacionin kontabel ne perputhje me Sistemin Uniform te LLogarive te aprovuara nga ERE. Viti i testimit do te jete nje periudhe historike 12 -mujore perfaqesuese e kostove operative te kompanise. ERE, gjate procedimit te aplikimit per tarife, ka te drejtë te kryej, ose kontrakoje per te kryer, nje auditim rregullator te informacionit kontabel te vitit testues te kompanise se shperndarjes.
- 5.2 Operatori i sistemit te shperndarjes mund te propozoje ndryshime te rezultateve te shpenzimeve te vitit te testimit per percaktimin e tarifave per vitin baze te periudhes se ardhshme rregullatore. Cdo ndryshim i tillë duhet te jete i njohur (nje artikull i vecante) dhe i matshem nga ana sasiore . Fondet e planikuara per mbulimin e kostove te ngjarjeve te pasigurta apo te pa parashikuara, nuk do te miratohen nga ERE. ERE do te marre ne konsiderate rregullime ne vitin e testimit te tillë si:
- 1) ndryshimi i kërkeses;
 - 2) inflacioni;
 - 3) ndryshime ne cmimin e kontraktuar;
 - 4) ndryshime ne taksa dhe sigurime;
 - 5) numri i klienteve te sherbyer;
 - 6) rritje e nivelit te aseteve baze te rregulluara;
 - 7) kosto e kapitalit;
 - 8) niveli i shpenzimit te amortizimit; dhe,
 - 9) faktori i eficences.
- 5.3 Operatori i Sistemit te Shperndarjes duhet te paraqese justifikime per cdo rregullim/korrigjim te parashikuar te rezultateve te vitit te testimit. Rregullimet duhet te specifikohen ne tabelat e paraqitura nga Operatori i Sistemit te Shperndarjes ne aplikimin per cmim, si dhe deshmi me shkrim duke dhene prova per arsyet dhe nivelin e cdo korrigjimi/rregullimi.

5.4 Per sherbimet e licensuara te rregulluara sipas metodes “price cap”, Operatori i Sistemit te Shperndarjes do te paraqese faktoret e rregullimit te vleresuar/parashikuar, te cilet qe do te perfshihen ne cdo vit te periudhes se rregullimit. Keta faktore do te perfshijne:

- 1) Bazen mesatare vjetore kumulative te aseteve te rregulluar per periudhen rregullatore;
- 2) Humbjet totale te energjise;
- 3) Faktorin vjetor te inflacionit; dhe,
- 4) Faktorin vjetor te permiresimit te eficences.

5.5 Kërkesat per te ardhura per vitin baze do te llogariten si vijon:

$$\mathbf{RR} = \mathbf{C} + (\mathbf{RAB} * \mathbf{WACC})$$

ku:

\mathbf{RR} jane kërkesat vjetore per te ardhura ;

\mathbf{C} kosto e lejuar vjetore e operimit per aktivitetin e licensuar,

\mathbf{RAB} Baza e Rregulluar e Aseteve;

$\mathbf{WACC} = \text{Mesatarja e Ponderuar e Kostos se Kapitalit para taksave}$

$$\mathbf{WACC} = [\mathbf{ES} * \mathbf{ARoE} / (1 - \mathbf{T})] + (\mathbf{DS} * \mathbf{CoD})$$

$$\mathbf{ES} + \mathbf{DS} = 1$$

Ku:

ES = Objektivi per raportin e kapitalit te vet ne RAB

T = Norma e takses se korporates

ARoE = Norma e lejuar e kthimit mbi kapitalin e vet pas takse

DS = Objektivi per raportin e borxhit ne RAB

CoD = Kosto e borxhit

5.6 Pagesat ne lidhje me qeramarjen (per shembull, marrja me qera e automjeteve) mund te perfshihet ne shpenzimet operative.

5.7 Kostot operative te operatorit te sistemit te shperndarjes qe mund te perfshihen ne kerkesen per te ardhura per sherbimet e licensuara, specifikohen ne tabelat standarte te aplikimit per tarife.

- 5.8 Operatori i sistemit te shperndarjes do te paraqese per miratim nga ERE nivelin mesatar te humbjeve teknike per cdo nivel tensioni ne rrjetin e shperndarjes. Kosto e blerjes se energjise/kapacitetit per te mbuluar humbjet jo teknike te energjise do te jete nje shpenzim operativ qe i alokohet FPP (klienteve tarifore) ne nivele te ndryshme te tensionit. Kosto e blerjes se energjise/kapacitetit per te mbuluar humbjet teknike te energjise do te jete nje shpenzim operativ i OSSH qe i alokohet sherbimit per perdonim te rrjetit ne nivele te ndryshme te tensionit.
- 5.9 Kerkesat per te ardhurat perfshijne te gjithe pagesat qe kompania e shperndarjes kryen tek ERE, me perjashtim te gjobave dhe kostove qe kane lidhje me sanksione.

6. Kthimi mbi Bazen e Rregulluar te Aseteve

- 6.1 Baza e Rregulluar e Aseteve per sherbimin e licensuar perfshin asetet materiale dhe jo-materiale minus amortizimin e akumuluar plus nje pjese te kapitalit te punes. RAB llogaritet sipas formules ne vijim:

$$RAB = A - CG - D + WC + INV ;$$

ku:

RAB Baza e Aseteve te Rregulluara;

A vlera e njojur e aseteve te perdonura dhe te dobishme ne fillim te periudhes rregullatore;

CG vlera e aseteve te perfutura nepermjet dhurimit ose te ndertuara me burime financiare te konsumatoreve te energjise elektrike.

D amortizimi i akumuluar per periudhen e kaluar te aseteve te perdonura per kryerjen e aktivitetit te licencuar; Amortizimi i investimeve te reja gjate periudhes rregullatore do te jete e barabarte me mestaren vjetore kumulative te amortizimit te mesvitit.

WC kerkesa per kapitalin e punes;

INV vlera mesatare nominale kumulative e investimeve e parashikuar per mesvitin, te miratuar nga ERE, qe do te investohen gjate periudhes se rregullimit.

- 6.2 ERE do te aprovoje RAB per vitin baze. Jo te gjithe astetet e kompanise se shperndarjes mund te perfshihen ne Bazen e Rregulluar te Aseteve per nje sherbim te licensuar, te cilit i caktohet cmim i vecante. Asetet qe nuk e mbeshtesin sherbimin e licensuar do te perjashtohen nga aseti baze i rregulluar. Shembuj te aseteve te perjashtuara jane asetet e perdonura per aktivitetet e palicensuara, pajisjet/mjetet e argetimit, dhe asetet mbi vlenen e tregut te blera nga operatori i sistemit te shperndarjes, etj. ERE, duke u bazuar ne vleresimin e konsulentit ose stafit te saj, duhet te percaktoje vlenen e tregut vetem ne rast te nivelit te diskutueshem te investimeve.
- 6.3 Nje nivel i kujdeshem i investimeve, i miratuar nga ERE, mund te perfshihet ne bazen e rregulluar te aseteve, te cilat mbeshtetin sherbimet e operatorit te sistemit te

shperndarjes per periudhat fillestare te rregullimit. Operatori i sitemit te shperndarjes do te paraqese ne ERE nje deshmi te shkruar mbi ndarjen e programit te propozuar te investimeve per periudhen e rregullimit, duke dhene shpjegime se ne c'menyre secila kategori kryesore do te jape shtesat e nevojshme ne kapacitet ose do permiresoje sherbimin dhe performancen e cilesise se furnizimit me energji elektrike.

- 6.4 Operatori i sitemit te shperndarjes do te tregoje amortizimin e akumular te llogaritur per te gjitha asetet qe perfshihen ne bazen e rregulluar te aseteve (RAB) per gjate viti te fundit te periudhes korrente rregullatore, dhe propozon nje vleresim te amortizimit per vitin baze te periudhes se ardhshme rregullatore.
- 6.5 Asetet rregullatore apo asetet per perdorim te ardhshem jane shpenzimet qe nuk kryhen ne menyre periodike, te cilat duhet te mbulohen nga OSSH per gjate nje periudhe kohe te caktuar. Shpenzimet jo periodike (qe nuk perseriten) perfshijnë demtimet nga katastrofat natyrore dhe shpenzimet qe lidhen me aplikimet per tarife.
- 6.6 Amortizimi i aseteve do te bazohet ne studimin me te fundit te amortizimit te paraqitur nga operatori i sitemit te shperndarjes dhe te aprovuar nga ERE i cili do te tregoje jetegjatesine e aseteve sipas kategorise bazuar ne nje studim teknik. ERE do te zbatuje sistemin fiskal per llogaritjen e amortizimit per qellime te rregullimit, por mund te vendose te perdore norma te tjera amortizimi ne raste te vecanta.
- 6.7 Operatori i sitemit te shperndarjes duhet te paraqese propozime per amortizimin e aseteve jo- materiale dhe aseteve te mbajtura per perdorim te ardhshem/rregullatore. ERE do te aprovoje te gjithe planin e amortizimit.
- 6.8 Vlera e lejuar e kapitalit te punes ne asetin baze te rregulluar duhet te bazohet ne nje studim te fondev qe kerkohen per te mbajtur nje nivel te pershtatshem te materialeve, furnizimeve dhe parave te nevojshme rezerve, per te permbushur detyrimet korrente dhe per te mbajtur llogarite minimale. Cdo studim i tille do te perfshihet ne aplikimin per cmim te paraqitur nga Operatori i Sistemit te Shperndarjes. Ne mungese te studimit, operatori i sitemit te shperndarjes mund te praqese nje vleresim te mases se lejuar te kapitalit te punes nepermjet nje evidence me shkrim duke justifikuar kete vleresim. Ne cdo rast kapitali i punes nuk do te kaloje 1/12 e Shpenzimeve Operative.
- 6.9 Norma e fitimit per operatorin e sitemit te shperndarjes nuk duhet te reflektoje ndonje aset te perfshuar nepermjet dhurimit.
- 6.10 Operatori i Sistemit te Shperndarjes do te paraqese rezultatet e cdo rivleresimi te aseteve materiale qe eshte kryer ne perputhje me Ligjin Shqiptar per Kontabilitetin dhe Standartet Nderkombetare te Kontabilitetit, i cili eshte perfunduar pas aplikimit te fundit per cmim te kompanise se shperndarjes. Operatori i sitemit te shperndarjes do te paraqese nje detajim te aseteve, sipas kategorive, te perfshira ne bazen e rregulluar te aseteve, para dhe pas cdo rivleresimi.
- 6.11 ERE do te percaktoje normen e pershtatshme te kthimit mbi Kapitalit te Vet pas taksave per Operatorin e Sistemit te Shperndarjes, e cila do te jetë e barabarte me normen e interesit te bonove te thesarit ne Shqiperi plus nje "prim" rishku qe lidhet me natyren e biznesit te nje operatori te sitemit te shperndarjes se energjise elektrike. ERE do te perdore Capital Asset Pricing Model ose metodologji te tjera, ku ERE do te marre ne konsiderate nje numer faktoresh, duke perfshire: (1) krahasime me kompani

te tjera qe kane risk te njejtë; (2) terheqjen e kapitalit; (3) kushtet aktuale financiare dhe ekonomike; (4) koston e kapitalit; (5) riskun e biznesit ; (6) politiken financiare dhe strukturen e kapitalit te kompanise; (7) kompetencen e menaxhimit; dhe, (8) historikun financier te kompanse.

- 6.12 ERE do te percaktoje koston normalizuar te borxhit per llogaritjen e normes se interesit te komponentit te borxhit. Llogaritja e kostos se normalizuar te borxhit do te bazoher ne normat e interesit per borxhin e pa paguar te operatorit te sistemit te shperndarjes. Normat e interesit te perdorura per percaktimin e kerkeses per te ardhura mund te jene ose te mos jene te njejta me normat aktuale te interesit te borxhit. Operatori i sistemit te shperndarjes duhet te treguje qe normat e interesit per borxhin jane ne perputhje me normat tregtare te interesit per borxhin te pranuara nga kompanite e tjera me risk te ngjashem krediti. Cdo borxh i perfshire ne llogaritjen e normes mesatare te interesit te borxhit, qe ka nje norme interesi me te larte se niveli aktual i tregut, do te rregullohet ne zbritje deri ne nivelin e tregut.

7. Sherbimet dhe Grupet e klienteve

- 7.1 Operatori i sistemit te shperndarjes do te siguroje pese lloje sherbimesh: sherbimet e perdorimit te rrjetit, matja dhe leximi i matesve, shkeputja dhe rilidhja e matesve, kompensimin e fuqise reaktive, dhe sherbime per lidhjet e reja.

7.1.1 **Perdorimi i rrjetit** – OSSH do te siguroje akses ne rrjet per furnizuesin publik me pakice, klientet jo tarifore, furnizuesit e kualifikuar dhe PVE-te. OSSH do te vendose per keta konsumatore nje pagese kapaciteti dhe nje pagese energjie. Pagesa e energjise per furnizuesin publik te shitjes me pakice do te perfshije humbjet totale te energjise ne rrjetin e shperndarjes, ndersa pagesa per energji per furnizuesit e kualifikuar, klientet jo tarifore dhe PVE-te nuk do te perfshije humbjet jo-teknike.

7.1.2 **Matja dhe leximi i matesve** – OSSH do te operoje dhe mirembaje te gjithe pajisjet e matjes dhe do te lexoje matesat sic kerkohet per klientet e shitjes me pakice te lidhur ne sistemin e shperndarjes.

7.1.3 **Sherbimi i shkeputjes dhe rilidhjes se matesve** – OSSH, me kerkese te furnizuesit publik me pakice ose furnizuesit te kualifikuar apo me me vullnetin e tij, shkeput nje klient per mos-pagim ose per shkelje te tjera ne perputhje me rregullat e sherbimit te klientit. Rilidhja, gjithashtu , do te behet sic percaktohet ne rregullat e sherbimit te klientit.

7.1.4 **Kompensimi i energjise reaktive** – OSSH do te ngarkoje te gjithe klientet mbi 50 kVA per kommpensimin e energjise reaktive. Llogaritja e pagesave gjate nje muaji, nese ka, jepen ne Seksionin 11 ne vijim.

7.1.5 **Lidhjet e reja** – Pagesa e cdo lidhjeje e re do te caktohet per klientet e shitjes me pakice ne perputhje me rregullat e lidhjeve dhe seksionin 12 ne vijim

- 7.2 Furnizuesi publik me pakice (FPP) do te kontrakoje per sherbimet e shperndarjes per llogari te klienteve tarifore. Klientet jo-tarifore, furnizuesit e kualifikuar dhe PVE-te do te fatuohen individualisht nga operatori i sistemit te shperndarjes.

7.3 Klientet e sherbimit te perdonimit te rrjetit do te ndahen ne grupe klientesh bazuar vetem ne nivelin e tensionit te lidhjes. Disa nengrupe klientesh mund te krijohen brenda cdo nivel tensioni.

8. Alokimi i kostove ne pagesa te perdonimit te rrjetit qe lidhen me energjine dhe kapacitetin

8.1 Cdo klient duhet te paguaje nje pagese energjie, ne Leke/kWh, bazuar ne numrin e kWh te levruar nga sistemi i shperndarjes tek klienti gjate atij muaji.

8.2 Klientet te pajisur me matesin e pershtatshem do te paguajne gjithashtu nje pagese kapaciteti per shperndarjen, nese eshte e pershtatshme, ne Leke/kW/muaj, bazuar ne vleren me te larte te ngarkeses pik jo-koincidues te klientit gjate periudhes 12-mujore qe mbaron me muajin e faturimit, ose ne kapacitetin kontraktual te garantuar. Per cdo tejkalim te vleres se kerkeses pik jo-koincidues mbi kapacitetin e garantuar ne kontrate, mund te aplikohet nje gjobe.

8.3 Ne nje aplikim per tarife, operatori i sistemit te shperndarjes duhet te parashikoje per cdo grup klientesh tarifore dhe jo tarifore (ne n/stacionet 110/x kV, ne tension te mesem, dhe tension te ulet) informacionin ne vijim:

- a) Nje vleresim te kapacitetit total te levruar ne kW te kerkuar per sigurimin e nje furnizimi te qendrueshem me energji ne cdo grup klientesh.
- b) Energjine totale ne kWh qe do te tregohet ne faturat e klienteve tarifore dhe jo tarifore ne cdo muaj te vitit baze dhe shumen e ketyre totaleve mujore
- c) Nje parashikim i humbjeve ne shperndarje qe i ngarkohen klienteve tarifore dhe jo tarifore ne cdo nivel tensioni (kosto e humbjeve do te perfshihet ne pagesat per energji (koston variabel) per secilin grup te konsumatoreve).

8.4 Kostoja fikse e te ardhurave te kerkuara alokohet per cdo grup te konsumatoreve tarifore dhe jo tarifore ne vitin baze. Tarifa e kapacitetit, ne leke per kW per muaj eshte:

$$P_{\text{kapacitet}} = \frac{\text{Kosto Fikse e Alokuar}}{L}$$

Ku, **L**- kapaciteti total i levruar, kW

8.5 Kostot qe lidhen me energjine ne te ardhurat e kerkuara alokohen per cdo grup te konsumatoreve tarifore dhe jo tarifore (ne n/stacionet 110/x kV, ne tension te mesem, dhe tension te ulet)

Cmimi i energjise, ne leke per kWh, eshte:

$$P_{\text{energji}} = \frac{\text{Kosto Variabel e alokuar}}{E}$$

E -energia totale ne kWh qe do te tregohet ne faturat e klienteve tarifore dhe klienteve jo-tarifore gjate vitit baze

8.6 Kosto variabel e alokuar per klientet tarifore do te perfshije koston per sigurimin e humbjeve totale te energjise, te ndara sipas niveleve te tensionit. Kosto variabel e

alokuar per klientet jo tarifore do te perfshije koston per sigurimin e humbjeve teknike te energjise, te ndara sipas niveleve te tensionit.

- 8.7 Per klientet mated i te cileve mat vetem konsumin energjise elektrike aktive ne kWh, cmimi per kWh llogaritet ne menyre qe te mbuloje kostot qe lidhen me kapacitetin dhe kostot qe lidhen me energjine:

$$P_{\text{vetem energji}} = (\text{Kosto Fikse e Alokuar} + \text{Kosto e Variabile alokuar})/E$$

$$\text{ku } E = \text{energjia totale ne kWh qe do te tregohet ne faturat perkates e klienteve tarifore dhe klienteve jo-tarifore gjate viti baze}$$

- 8.8 Operator i Sistemit te Shperndarjes mund te paraqese ne ERE nje aplikim per cmime te energjise pik/jo-pik ne sistemin e tarifave te perdonimit te rrjetit. Ne kete aplikim do te kete dy vlera te energjise: (i) nje qe i korespondon periudhave pik (kur humbjet e rrjetit jane me te larta dhe vlera e energjise eshte me e larte), dhe (ii) nje qe i korespondon periudhave jo-pik (kur humbjet e rrjetit jane Jane me te uleta dhe vlera e energjise eshte me e ulet). Ne aspektet e tjera metodologjia e tarifave do te jetë njelloj. Operatori i Sistemit te Shperndarjes duhet te shpjegoje ne aplikimin e tij per tarifa kostot dhe perfitimet nga zbatimi i struktures se tarifave pik dhe jo pik per perdonimin e rrjetit te shperndarjes. Metoda pik/jo-pik kerkon mated me te shtrenjte qe mund te justifikohen vetem me diferenca e cmimeve pik/jo-pik per energjine e gjeneruar dhe te importuar dhe ne lidhje me cmimet pik dhe jo-pik te FPP, mund te justifikohet blerja e matedve te kerkuar.

9. Sherbimet qe lidhen me Matjen

- 9.1 OSSH do t'i ofroje sherbime te matjes furnizuesit publik me pakice dhe furnizuesve te kualifikuar.
- 9.2 OSSH do te ngarkoje furnizuesit me nje pagese per sherbin e matjes dhe leximin e matedve per cdo klient qe furnizohet me energji nga furnizuesit. Te gjitha kostot qe lidhen me instalimin, operimin, mirembajtjen, kalibrimin dhe leximin e matedve te shitjes me pakice dhe shumice do te perfshihen ne kerkesat per te ardhura te alokuara per kete sherbin, te ndara sipas niveleve te tensionit. Cmimi do te percaktohet nga pjestimi i kerkeses totale per te ardhura per nivelin e vecante te tensionit me numrin e klienteve te lidhur ne ate nivel tensioni.
- 9.3 OSSH ngarkon pagesa per nderprerjen dhe rilidhjen e matedve. Kerkesat per te ardhura per keto sherbime duhet te perfaqesojne koston mesatare vjetore per sigurimin e ketij sherbimi. Ka nje cmim ne kohen e rilidhjes qe do te perfshije koston e nderprerjes se lidhjes, e cila duhet te parapaguhet perpara se te behet rilidhja. Te ardhurat e kerkuara te alokuara per nderprerjen e lidhjes dhe rilidhjen, duhet perfshijne shpenzimet qe lidhen me punen, transportin, si dhe shpenzime te tjera administrative qe lidhen me kryerjen e ketij sherbimi.

10. Percaktimi i tarifes mesatare tavan te sherbimit te shperndarjes

- 10.1 Per vitin baze, tavani i tarifes mesatare te shperndarjes eshte i barabarte me tarifen mesatare te shperndarjes te llogaritur ne perputhje me kostot e vtit baze.
- 10.2 Per vitin e dyte te ciklit te rishikimit te tarifes te shperndarjes (Viti 2), cdo komponent i tarifes se perdonimit te rrjetit te shperndarjes per vitin baze shumezohet me faktorin vjetor te rregullim/korigjimit:

$$A = (1 + RPI - X)$$

A - faktori vjetor i rregullim/korigjimit

RPI - norma e parashikuar e inflacionit te cmimit te konsumatorit per Vitin 2 sipas Bankes Kombetare Shqiptare, ose e vendosur nga ERE ne baze te prirjes se statistikave te indeksit te cmimeve te konsumatorit gjate periudhes se 3 viteve te fundit per te cilin disponohen te dhena historike (nga burime te INSTAT).

X - faktori i permiresimit te eficences i vendosur nga ERE

- 10.3 ERE do t'i shtoje kesaj formule nje faktor te permiresimit te performances te bazuar ne cilesine e furnizimit te klienteve tarifore dhe klienteve jo-tarifore ose ne nivelin e humbjeve te energjise ne rrjetin e shperndarjes. Keta faktore te permiresimit te performances duhen percaktuar shume qarte dhe thjeshte dhe operatori i sistemit te shperndarjes duhet te siguroje ERE-n qe eshte e afte te siguroje te dhenat per cilesine e furnizimit qe nevojiten per te matur me saktesi permiresimin e performances.
- 10.4 Vlera e X-it duhet percaktuar ne baze te studimeve referuese te operatoreve te sistemit te shperndarjes, ku shqyrtohet performanca e te pakten 3 operatoreve te sistemit te shperndarjes gjate nje periudhe prej te pakten 3 vjetesh.
- 10.5 Faktori X do te perfshije te pakten kater kategori te shpenzimeve: puna direkte dhe indirekte, produktiviteti i punes, prokurimi, dhe teknologja. Teknologja do te perfshije implementimin e sistemeve te menaxhimit dhe pakesimin e humbjeve teknike.
- 10.6 Per cdo vit pasues te periudhes rregullatore, tarifat e shperndarjes per vitet e meparshme do te shumezohen me nje faktor vjetor te rregullimit sic u veprua ne Vitin e dyte.

11. Pagesa per Energjine Reaktive

- 11.1 Kompensimi i energjise reaktive normalisht eshte nje sherbim ndihmes i siguruar nga gjeneruesit per OST, dhe si rrjedhim pagesat per energjine reaktive jane pjesa e tarifes se Operatorit te Sistemit Transmetimit. Nese operatori i sistemit te shperndarjes deshton vazhdimesht te permbushi standartet e tensionit te vendosura ne interkonjekcionin midis rrjetit te transmetimit dhe shperndarjes, OST mund t'i ngarkoje operatorit te sistemit te shperndarjes penalite per energjine reaktive. Operatori i sistemit te shperndarjes mund te instaloje kapacitete te energjise reactive

ose reaktore sipas nevojes ne vend qe t'i paguaje penalite kompanise se transmetimit.

- 11.2 Gjithashtu, operatori i sistemit te shperndarjes ka te drejte t'i kerkoste nje klienti te rrjetit te shperndarjes te mbaje nje faktor fuqie te caktuar ne piken e lidhjes me rrjetin e shperndarjes.
- 11.3 Klientet me kapacitet prej 50 kVA e lart paguajne nje shume mbi vleren e energjise elektrike aktive ne varesi te energjise reactive te perdorur dhe te cliruar me faktor mesatar mjaft te kapacitetit me te vogel se 0.9 gjate dites dhe zones se pikut ditor.
- 11.4 Sasia e energjise reaktive te perdorur, per te cilen paguhet nje shume sipas pikes 11.3, eshte diferenca pozitive midis sasise te energjise reactive te perdorur dhe produktit te sasise energjise elektrike active te perdorur me nje koeficient korrespondues te faktorit mesatar mjaft te fuqise, sipas formules:

$$E_{r\ alwn} = E_{r\ used} - (E_{a\ used} \times (1 - F))$$

ku:

$E_{r\ alwn}$ eshte sasia e energjise elektrike reaktive ne kVarh qe paguhet,;

$E_{r\ usd}$ sasia e energjise reaktive te konsumuar nga klienti gjate periudhave te dites

$F = 0.9$, per konsumin e energjise reaktive pa pagese midis vlerave 1 dhe 0.9 te faktorit te fuqise.

$E_{a\ usd}$ sasia e energjise aktive te perdorur nga klienti sipas zonave te dites, e percaktuar nepermjet leximeve te pajisjeve per matje komerciale te energjise elektrike aktive, kWh.

- 11.5 Klientet sipas Pikes 11.3 paguajne nje shume per sasine e energjise elektrike reaktive ($E_{r\ alwn}$) percaktuar sipas Pikes 11.4 me nje cmim per 1 kVarh, te barabarte me [] per qind te cmimit te rregulluar te furnizimit publik per kWh energji elektrike aktive per zonen perkatese te dites dhe nivelin perkates te tensionit.
- 11.6 Klientet sipas Pikes 11.3 paguajne nje shume per sasine e energjise reaktive te cliruar gjate oreve te pikut, te percaktuar sipas leximeve te pajisjeve per matje komerciale, me nje cmim per 1 kVarh, te barabarte me cmimin e rregulluar te furnizimit publik per 1 kWh energji elektrike aktive ne pik per nivelin perkates te tensionit.
- 11.7 Kurdo qe klientet sipas pikes Section 11.3 prodhojnë energji elektrike dhe nxehtesi me ciklo te kombinuar gjenerimi, ata nuk i paguajne operatorit te sistemit te shperndarjes nje shume mbi energjine e cliruar reaktive te prodhuar nepermjet ciklit te kombinuar te gjenerimit.

12. Cmimet e Lidhjeve te Reja ne Rrjetin e Shperndarjes

- 12.1 Tarifat per lidhjen e konsumatoreve ne sistemin e shperndarjes do te miratohen nga ERE. Keto tarifa paguhën nga konsumatoret e rinj te lidhur ne rrjet, nga konsumatoret

ekzistues qe kerkojne rritje te fuqise, dhe nga konsumatoret /zoterues te centraleve prodhuese te energjise elektrike (si PVE-te)

- 12.2 Klientet e rind paguajne cmimin per lidhjen me rrjetin e shperndarjes, i cili perfshin vetem shpenzimet direkte per lidhjen e instalimeve te klientit me rrjetin e shperndarjes se energjise elektrike te kompanise.
- 12.3 Cmimet per lidhjen e pajisjeve te klientit mbi 50 kVA te kapacitetit te kontraktuar percaktohen sipas nje projekti individual dhe percaktohen nepermjet llogaritjes se shpenzimeve individuale te projektit, duke perfshire shpenzimet e nevojshme per realizimin e lidhjes midis instalimit te pajisjes dhe pikes me te afert te rrjetit perkates ne te cilin eshte e mundur te behet lidhja.
- 12.4 Cmimet e lidhjeve te reja percaktohen sipas grupeve te klienteve, dhe perfshijne nje komponent konstant dhe nje komponent variabel, te cilet aprovoohen nga ERE.
- 12.5 Cmimet e aprovuara nga ERE per lidhjet nuk jane subjekt i diferencimit sipas niveleve te fuqise midis kufirit te ulet dhe te siperm te fuqise brenda grupeve respektive.
- 12.6 Komponenti konstant percaktohet per numrin minimal te grupeve te konsumatoreve ne varesi te fuqise se konsumatoreve si vijon:
1. grupi i klienteve deri ne 6 kW;
 2. grupi i klienteve nga 7 deri 15 kW;
 3. grupi i klienteve nga 16 deri 50 kW;
 4. grupi i klienteve nga 51 deri 100 kW;
 5. grupi i klienteve nga 101 deri 200 kW;
 6. grupi i klienteve nga 201 deri 500 kW;
 7. grupi i klienteve nga 501 deri 1000 kW.
- 12.7 Operatori i sistemit te shperndarjes ka te drejte te dorezoje per aprovim ne ERE propozime per ndryshimin e grupeve te klienteve.
- 12.8 Cmimet per lidhjen e klienteve fuqia e te cileve tejkalon fuqine maksimale te percaktoar ne Piken 12.6 percaktohen mbi baze te projekteve individuale.
- 12.9 Komponenti variabel percaktohet ne baze te distances nga pajisja (facility) deri ne piken me te afert te rrjetit per tensionin respektiv, ne te cilin eshte e mundur qe te realizohet lidhja, ose tek nenstacioni i transformimit me i afert.
- 12.10 Komponenti variable eshte i barabarte me zero ne ato raste kur distanca sipas Pikes 12.9 eshte me e vogel ose e barabarte me 25 metra.
- 12.11 Pervec rasteve te Pikes 12.10, cdo meter kabell ose linje ajrore shtese do te paguhet me cmimin per grupin respektiv te klienteve, cmim ky i aprovar nga ERE.
- 12.12 Komponenti konstant i cmimeve te lidhjeve eshte shprehje e shpenzimeve mesatare per lidhjen e nje klienti qe i perket nje grupi te caktuar dhe percaktohet nepermjet formules ne vijim:

N

$$C_{pr(i)} = \frac{\sum_{i=1}^n S(i) (\text{Shpenzimet per lidhjet ne grupin } i)}{N}$$

ku:

$C_{pr(i)}$ = cmimi i lidhjes se nje konsumatori qe i perket grupit **i** te klienteve , Leke;

$S(i)$ = shpenzimet per lidhjen – shpenzimet totale per lidhjen per grupin **i** te klienteve per vitin para vitit ne te cilin eshte bere propozimi per ndryshimin e cmimit, (ne leke);

N = numri i lidhjeve te bera per grupin **i** te klienteve per vitin pasardhes.

12.13 Komponenti fiks i shpenzimeve te lidhjes perfshin:

1. per grupet deri ne 50 kW te fuqise se lidhur: shpenzimet per furnizimin dhe instalimin e panelit te matesit (electrometer board), instalimin e sistemit te kabllave elektrike per nje distance deri 25 metra, furnizimin dhe instalimin i pajisjeve te nevojshme per qellime specifike (te vecanta);
2. per grupet nga 50 deri 200 kW te fuqise se lidhur: shpenzimet per furnizimin dhe instalimin e pajisjeve te nevojshme dhe linjave (wiring) qe nevojiten per nenstacionin e transformimit te voltazhit dhe paneli te matesit (electrometer board), instalimi dhe shtrimi i linjes per nje distance deri 25 meter, furnizimi dhe instalimi panelit te matesit (electrometer board) dhe pajisjeve te tij;
3. per grupet nga 200 deri 1000 kW te fuqise se lidhur:
 - a) shpenzimet e nevojshme per nenstacionin e transformimit te voltazhit nga pikpamja e fuqise se kerkuar, ndertimin e nenstacionit, pajisjen e tij me aparatet e nevojshme, shtrimin e linjes, furnizimi dhe instalimin e aparateve te sistemit te matje;
 - b) shpenzimet per lidhjen e nenstacionit e transformimit te voltazhit me rrjetin e shperndarjes se energjise ne tensionin perkates nepermjet instalimit te nje linje ajrore prej 1 x 25 meter ose nje linje kabllore prej 2 x 25 meter.

12.14 Komponenti variabel i cmimit per lidhjen e re perbehet nga shpenzimet per instalimin e linjes (telave) per nje distance nga pika me e afert e lidhjes se rrjetit te shperndarjes te niveleve respective te tensioneve deri ne panelin mates te klientit (per grupet deri 200 kW te fuqise se kerkuar) ose tek nenstacioni i transformimit te tensionit (per grupet nga 200 ne 1000 kW), pakesuar me shpenzimet per 25 meter linje.

12.15 Percaktimi i siperpermendur i cmimit eshte per nje lidhje me linje teke, ose e nivelit te trete (III) te sigurise se sherbimit per klientet. Ka dy nivele te tjera me te larta sigurie, Niveli II dhe Niveli I. Siguria e permiresuar arrihet nepermjet fuqizimit te mbrojtjes, duke perfshire qarqe te shumfishte ne pronen e klientit. (Kjo duhet te jete ne perputhje me Kodin e Shperndarjes).

12.16 Cmimet e lidhjes per kategorite e tjera percaktohen si vijon:

Cpri (II) = 1.8 * Cpri (III);
Cpri (I) = 2.8 * Cpri (III),

ku:

Cpri (III) eshte cmimi i lidhjes per grupin e i-te te klienteve, kategoria e trete e sigurise, ne leke;

Cpri (II) – cmimi i lidhjes per grupin e i-te te klienteve, kategoria e dyte e sigurise , ne leke.;

- 12.17 Cpri (I) – cmimi i lidhjes per grupin e i-te klienteve, kategoria e pare e sigurise, ne leke.
- 12.18 Pagesat e lidhjes per pajisjet e reja gjeneruese te lidhura direkt me sistemin e shperndarjes do te percaktohen mbi baze rast pas rasti. Pagesa e lidhjes duhet te mbuloje vetem koston e aparateve matede dhe linjat qe jane ndertuar vetem per lidhjen e gjeneruesit te ri me rrjetin.
- 12.19 Asetet e financaura nepermjet pagesave te lidhjes mund te mos perfshihen ne asetin baze te rregulluar te operatorit te sistemit te shperndarjes. Amortizimi i ketyre aseteve nuk do te mbulohet nga pagesat e perdonimit te rrjetit.

13 Afatet

- 13.1 Bazuar ne keto metodologji, Operatori i Sistemit te Shperndarjes do te dorezoje ne ERE nje kerkese per aprovimin e tarifave te reja, jo me vone se 6 muaj para dites ne te cilen kerkohet qe te hyjne ne fuqi tarifat e reja te propozuara.
- 13.2 Operatori i Sistemit te Shperndarjes do te dorezoje ne ERE te dhena mbi kostot e vitit te meparshem dhe tarifat (cmimet) mesatare sipas struktures se shitjes, brenda muajit prill te vitit ne vijim
- 13.3 ERE, brenda muajit Maj, shqyrton keto te dhena dhe nese rezultojne devijime nga kostot dhe tarifat (cmimet) e miratuara prej saj qe rendojne klientet, vendos per reimbursimet qe kompania duhet te beje ndaj tyre gjate vitit pasardhes.

14 Dispozita Kalimtare

- 14.1 Periudhat rregullatore do te jene sipas Deklarates Rregullatore per zbatimin e metodologjive te llogaritjes se tarifave, e cila miratohet nga ERE
- 14.2 Tarifat per periudhen e trete te rregullimit do te bazohen ne te dhenat financiare ne perputhje me Standartet e Njejtta te Llogarive per qellime te rregullimit te miratuara nga ERE dhe Standartet Nderkombetare te Raportimit Financiar/IFRS

- 14.3 Per tre periudhat e para te rregullimit objektivi i strukture se kapitalit per OSSH do te jete sipas Deklarates Rregullatore te publikuar nga ERE.
- 14.4 Vlera e lejuar e kthimit nga kapitali i vet pas takse fillimisht do te jete sipas Deklarates Rregullatore te publikuar nga ERE.
- 14.5 Per periudhen e pare rregullatore :
- (1) Struktura e tarifave te operatorit te sistemit te shperndarjes ne periudhen e pare rregullatore do te jete e njeje me ate qe egziston ne Mars 1, 2009.
- (2) Operatori i sistemit te shperndarjes mund te dorezoje nje aplikim ne ERE per rishikimin e strukture se tarifave brenda periudhes se dyte ose te trete rregullatore nese Operatori i Sistemit te Shperndarjes jep nje studim per “percaktimin e tarifes” te bazuar ne modelet e perdorimit nga klientet dhe koston e sherbimit te grupeve te klienteve te ndryshem.
- (3) Tarifat per cdo sherbim te shperndarjes do te rriten uniformisht duke u bazuar ne rritjen e kerkesave per te ardhura te periudhes se meparshme.
- 14.6 Programi per reduktimin dhe eliminimin ne nivelin me te mundshem te humbjeve te energjise eshte perqejegjesi e operatorit te sistemit te shperndarjes. ERE do te vendose targeta per reduktimin e humbjeve te energjise brenda periudhes rregullatore. Nje studim per vleresimin e humbjeve teknike sipas secilit nivel tensioni do te sigurohet nga i licensuari ne momentin e aplikimit per tarife.

15 Dispozita perfundimtare

Metodologja e Llogaritjes se Tarifave te Operatorit te Sistemit te Shperndarjes u miratua nga Bordi I Komisionereve te ERE-s me ane te vendimit nr. 79, date 26/06/2008.